



Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

Informatat rreth aktiviteteve të Trupit Koordinues

(nëntorë 2009 – maj 2010)

Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunitet Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë paraqet raportin rreth aktiviteteve për periudhën nëntorë 2009 - maj 2010.

Trupi Koordinues në përputhje me definimin e prioriteteve ka arritur suksese të konsiderueshme në periudhën e kaluar:

a) Në sferën politike – Sipas Marrëveshjes mbi principet e rekonstruimit të Trupit Koordinues, është paraparë formimi i 6 grupeve punuese: Grupi Punues për zhvillim ekonomik dhe infrastrukturë, Grupi Punues për integrime politike dhe integrime shoqërore, Grupi Punues për siguri dhe gjyqësi, Grupi Punues për përforsimin e kapaciteteve të pushteteve lokale dhe aftësimi i tyre për vetëqëndrueshmëri, Grupi Punues për arsim, kulturë, sport dhe informim dhe Grupi Punues për shëndetësi dhe politikë sociale. Të gjitha Grupet Punuese kanë pasur takime në të cilat janë definuar qëllimet dhe prioritetet e punës së qdo grupi individual. Anëtarët e grupeve punuese janë përfaqësuesit e ministrisë dhe përfaqësuesit e pushteteve lokale të komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Përfaqësuesit e Trupit Koordinues poashtu marrin pjesë në punën e grupeve punuese.

b) Në sferën e ekonomisë – Trupi Koordinues në vitin 2009 ka investuar 228.576.607,18 dinarë në projekte infrastrukturore me qëllim të përmirësimit të gjendjes ekonomike në komunitet Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, nga të cilat mjete prej Planin Nacional Investiv (PIN) janë ndarë 57.757.340,73 dinarë. Në vitin 2010 në projektet infrastrukturore do të investohen gjithsej 241.278.000,00 dinarë nga buxheti i Trupit Koordinues nga e cila sumë nga PIN-i do të ndahen 2.996.728,24 dinarë. Përpos investimeve të drejtëpërdrejta në infrastrukturë, në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me departamentet e ministrisë, Trupi Koordinues ka punuar në përfshirjen e këtyre komunave në projektet vendore dhe ato ndërkombëtare të cilat merren me zhvillimin ekonomik.

c) Në sferën e integrimeve – Trupi Koordinues në këtë periudhë ka shpallur tri konkurse për shpërndarjen e mjeteve financiare për projekte të shoqërive civile dhe ndihmë për kategoritë e rrezikuara. Komisionin për seleksionimin e projekteve e përbëjnë përfaqësuesit e komunave dhe përfaqësuesit e Shërbimit të Trupit Koordinues. Komisioni në vitin 2009 ka miratuar 14.580.984,00 dinarë ndërsa këtë vitë në konkursin e parë janë miratuar 16.831.996,00 dinarë. Suma e përgjithshme e mjeteve për realizimin e projekteve të shoqatave të qytetarëve në komunitet Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës e cila do të miratohet për vitin 2010 është **20 milion dinarë**, ndërsa për projekte për përmirësimin gjendjes sociale të pakicave kombëtare do të investohen **25 milion dinarë**.

Trupi Koordinues, në bashkëpunim me Ministrinë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, ka organizuar një sërë aktivitetesh për të cilat aktivitete komunitetit Shqipëtarë u është mundësuar informimi mbi kompetencat dhe mënyrën e punës së Këshillave Nacionale të pakicave kombëtare.

d) Në relacionet ndërkombëtare – Në këtë periudhë Trupi Koordinues, me qëllim të përmirësimit të jetës në komunitet Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, ka mbajtur një sërë takimesh me partnerët ndërkombëtarë: UNDP, OSBE-në, shoqatën Gjermane për medijim intergrativ (DSSP). Në takimet me përfaqësuesit e ambasadave të SHBA-së, Britanisë së Madhe, Greqisë, Austrisë dhe Norvegjisë është rënë dakord komunikimi kontinuel dhe mbështetja për zhvillimin ekonomik të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

e) Në komunikimin publik – Shërbimi i Trupit Koordinues raporton publikisht rreth punës përmes raporteve në webfaqen e sajë, raporton mbi kryetarin e Republikës së Serbisë, Qeverinë e Republikës së Serbisë, mbi mediat dhe partnerët ndërkombëtarë.

Kryetari i Trupit Koordinues, ministri Milan Marković u është drejtuar qytetarëve të komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me një letër të hapur ku në gjuhën e tyre amtare u ka prezentuar aktivitetet dhe rezultatet e punës së Trupit Koordinues.

f) Nga sfera e arsimit– Trupi Koordinues ka përkrahur dhe pjesërishtë ka finansuar projektin „Reforma e politikës arsimore në Serbinë jugore” i cili ka rezultuar studion e vizibilitetit rreth mundësisë së zhvillimit të shkollimit të lartë në Serbinë jugore. Projekti është realizuar nga organizatat joqeveritare Qendra për rezistencë jo të dhunshme dhe Qendra për politika arsimore nga Beogradi. Sudioja është shkruar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Studion e vizibilitetit e ka finansuar Fondi për shoqëri të hapur, Fondi Ballkanik për demokraci dhe Trupi Koordinues.

Aktivitetet më të rëndësishme të Trupi koordinues janë:

- **Hapja e minierës Lece në Medvegjë**– Në fillim të muajit prill është hapur miniera Lece në



Medvegjë në të cilën minierë deri në vitin 2011 do të punësohen 300 minatorë. Minierën e hapi kryetari i Republikës së Serbisë Boris Tadiq. Rimëkëmbja e kësaj miniere është mundësuar nga ana e kompanisë Farmakom MB nga Shabaci. Në hapjen solemne të kësaj miniere kanë marrë pjesë kryetari i Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë Milan Marković. Trupi Koordinues në bashëpunim me kryetarin e komunës së Medvegjës Slobodan Drashkovićin kanë ndihmuar në mbrojtjen dhe fillimin e punës së kësaj miniere. Gjatë përgatitjes së hapjes së kësaj miniere, kryetari i Trupit

Koordinues, ministri Milan Marković, në janar ka vizituar komunën e Medvegjës me delegacionin e afaristëve në krye me pronarin dhe drejtorin e kompanisë Farmakom MB Miroslav Bogiqeviq. Në këtë delegacion ka marrë pjesë edhe sekretari pranë Ministrisë së energjisë dhe minierave Radivoje Milanović, përfaqësuesit e fabrikës së akumulatorëve nga Sombori, qumështores nga Shabaci, kombinatit industrial Guça, shkrites Pozhega, minierës dhe shkrites nga Zajeçari, PIK 7 juli, Kombinatat bujqësorë Beograd, RDS grupi dhe RTB Bor. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë marrëveshja për rihapjen e minierës Lece si dhe mundësia e investimeve të reja në komunën e Medvegjës.

- **Prezentimi i studios së vizibilitetit rreth mundësive të zhvillimit të shkollimit të lartë në Serbinë jugore**– Trupi Koordinues, Qendra për rezistencë jo të dhunshme dhe Qendra për politika arsimore në



mar kanë prezentuar rezultatet preliminare së Studios së vizibilitetit për hapjen e shkollave të larta në Preshevë dhe Bujanoc. Takimin e shpalli të hapur drejtori i Shërbimit të Trupit Koordinues Nenad Gjurgjeviq, duke potencuar se realizimi i kësaj Studioje është projekti primar në vitin 2010. Qëllimi i kësaj Studioje është shqyrtimi i kërkesave, potencialeve dhe resurseve për hapjen e shkollave të larta në Serbinë jugore dhe formulimi i rekomandimeve për hapjen e këtij institucioni në Preshevë dhe Bujanoc. Prezentimit të Studios së vizibilitetit i kanë parapri dy

diskutime publike në Bujanoc dhe Beograd, ku sugjerimet dhe propozimet e tyre i kanë paraqitur përfaqësuesit e të gjitha bashkësive etnike nga Presheva dhe Bujanoci. Në prezentimin i cili është mbajtur në Beograd ka marrë pjesë edhe komesari i lartë i OSBE-së për të drejtat e njeriut dhe

pakicave Knut Volebek, përfaqësuesit e zyrës së OSBE-së nga Haga Robert Shup dhe Sebastijan Dvorzhak, misionit të OSBE-së nga Beogradi, përfaqësuesit e ambasadave dhe donatorët. Në fund të muajit prill Studioja e vizibilitetit është publikuar në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Trupi Koordinues këtë projekt ka mbështetur financiarisht, si dhe ka ndihmuar në mënyrë logjistike, ku është vërtetuar përkushtimi i sajë për zgjidhjen e problemit të arsimit në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

• **Bursistët e Trupit Koordinues vizituan Beogradin** – Trupi Koordinues në gusht të vitit 2009 ka



shpërndarë bursa për 148 nxënës të shkollave të mesme nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Bursën në shumën prej 5.000,00 dinarë nxënësit e shkollave të mesme do ta marrin deri në mbarim të vitit shkollorë. Nxënësit nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja në Beograd kanë vizituar institucionet më të rëndësishme shtetërore. Me bursistët ka biseduar kryetari i Republikës së Serbisë Boiris Tadiq, kryetarja e parlamentit Slavica Gjukiq Dejanović dhe ndihmësja e kryetarit të Beogradit Radmila Hrustanović. Në fundë të vizitës, kryetari i Trupit Koordinues, ministri

Milan Marković dhe ministri i arsimit Zharko Obradović, nxënësve të shkollave të mesme u kanë dorëzuar kontratat mbi bursën.

Kjo është hera e parë që Trupi Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë ndanë bursë nxënësve të shkollave të mesme të cilët kanë kushte të rënda ekonomike. Konkursi i ardhshëm për shpërndarjen e bursës do të shpallet kah mesi i qershorit të vitit 2010. Këtë aksion ka mbështetur Srpska banka e cila qdo bursisti i ka dorëzuar librezën e kursimit me 5.000,00 dinarë të deponuar.

• **Janë shpërndarë mjetet financiare në Konkursin e Shërbimit të Trupit Koordinues** – Komisioni i Shërbimit të Trupit Koordinues në nëntorë të vitit 2009 ka shpallur konkursin e dytë për realizimin e projekteve të shoqatave të qytetarëve të komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Shërbimi i Trupit Koordinues nga buxheti i sajë, shoqatave të qytetarëve për realizimin e projekteve të këtij konkursi i ka ndarë gjithsej 3.525.992,00 dinarë. Në konkurs kanë arritur gjithsej 30 propozim projekte, ndërsa mjete janë lejuar për finansimin e 9 projekteve. Disa nga projektet për realizimin e të cilëve janë lejuar mjetet financiare, kanë për qëllim përparimin e gjendjes së bashkësisë Rome, hapja e një hapësire në radiostacione për informim në gjuhën rome. Pasiqë si prioritet i Trupit Koordinues është rinia, shumë nga projektet e lejuara kanë pasur për qëllim përmirësimin e gjendjes së rinisë, mirëkuptimi ndaj kërkesave të tyre, promovimi i bashkëpunimit të rinisë nga të gjitha bashkësitë etnike si dhe përforcimi i aktiviteteve multietnike. Në këtë konkurs janë lejuar mjete edhe për projekte të cilat promovojnë bashkëpunimin multietnik nga sfera e sportit siq është shkolla e volejbollit, mirëpo edhe ata të cilët merren me promovimin e barazisë gjinore.

Shërbimi i Trupit Koordinues në mars të vitit 2010 ka shpallur konkursin e tretë për finansimin e projekteve në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Janë paraqitur 85 propozim projekte. Mjete janë lejuar për finansimin e 24 organizatave. Janë lejuar mjete që kapin shumën prej 16.832.362,00 dinarësh. Në përputhje me prioritetet e Trupit Koordinues, ka vazhduar puna e finansimit të projekteve të cilat në mënyra të ndryshme kanë të bëjnë me rininë dhe bashkëpunimin ndëretnik.. Trupi Koordinues ka mbështetur aktivitetet multietnike sportive si dhe mediat për informim në gjuhët e të gjitha pakicave kombëtare. Për herë të parë në konkurs është lajmëruar projekti i kooperativës bujqësore multietnike të cilës u është lejuar finansimi i mbjelljes pranverore.

- **Premiera dhe turneja e çfaqjes „Ti dhe unë jemi ne”**– Pop shou tinxher „Ti dhe unë jemi ne”, çfaqja teatrale mbi jetën rinore në Serbinë jugore, për të parën herë është çfaqur në Bujanoc në dhjetorë të vitit të kaluar. Gjatë çfaqes së sajë në Beograd, në teatrin e vogël Dushko Radvoiq ka pasur ovacione të jashtëzakonshme nga publiku. Artistët e rinjë në muajin shkurt dhe mars të vitit 2010 kanë qenë mysafir në Kikindë, Zrenjanin, Sremska Mitrovicë, Shid dhe Sombor.. Gjatë turnesë së tyre nëpër Vojvodinë, ministri Milan Markoviq, kryetari i këshillit ekzekutiv, dr Bojan Pajtiq, kryetarët e komunave dhe përfaqësuesit e grupit të shkollave të mesme të



çfaqjes „Ti dhe unë jemi ne” kanë mbajtur konferencën për shtyp. Ky projekt është finansuar nga Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Nxënësit e shkollave të mesme nga Presheva dhe Bujanoci me çfaqjen multietnike „Ti dhe unë jemi ne” kanë marrë pjesë edhe në Vokuov Sabor-in të nxënësve, të nëntin me radhë i cili mbahet në Lloznicë.

- **Formohen të gjitha grupet punuese**– Në këtë periudhë janë mbajtur takime konstituive të katër grupeve punuese: Grupet punuese për integritet politik dhe shoqëror, Grupet punuese për siguri dhe jurisprudence, Grupet punuese për përfundimin e kapaciteteve të pushteteve lokale dhe aftësimi i saj për zhvillim të tutjeshëm dhe Grupet punuese për shëndetësi dhe politikë sociale. Takimet janë mbajtur në Beograd, Preshevë dhe Bujanoc. Është mbajtur takimi i katër me radhë i Grupit punues për arsim, kulturë, sport dhe informim. Është paraparë dialogu i mëtutjeshëm për zgjidhjen e problemeve nga sfera e cila është nën kompetencat e këtij grupi punues.

- **Trupi Koordinues ka bështetur aksionin e dhënies vullnetare të gjakut**– Organizata e vullnetarëve të gjakut të stacionit policorë të Vranjës në dhjetorë të vitit 2009 në stacionin policorë të Preshevës ka organizuar aksionin e dhënies vullnetare të gjakut. Gjatë këtij aksioni janë mbledhë 86 njësi gjaku. Në këtë aksion, në dhënie vullnetare të gjakut kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e zyreve të Trupit Koordinues nga Bujanoci dhe Presheva.

- **Vizita e kryetarit të Trupit Koordinues në paralelet e fakultetit në Medvegjë**– Ministri Milan Markoviq në janarë të këtij viti ka vizituar studentët e paraleles së fakultetit Juridik dhe Ekonomik në Medvegjë, fakultet i cili është hapur në tetorë të vitit të kaluar. Ministri Markoviq gjatë kësaj vizite ka biseduar me dekanët e këtyre dy fakulteteve si dhe me studentët rreth problemeve që i preokupojnë, sidomos mbi realizimin e mësimit në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe. Gjatë vizitës së tij, ai ndau tekstet shkollore në gjuhën shqipe.

- **Takimi i Kryesisë së Trupit Koordinues në Bujanoc** – Në shkurt të këtij viti është mbajtur takimi i Kryesisë së Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Ky ka qenë takimi i pestë me radhë që nga rekonstruimi i Trupit Koordinues. Në këtë takim është shqyrtuar raporti i punës së Trupit Koordinues për periudhën e vitit 2009 si dhe shpërndarja e mjeteve financiare për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Njëzëri është rënë dakord se nga suma prej 229.278.000,00 dinarësh të transferuara nga buxheti republikan për këtë vitë, komunës së Bujanocit do t’i takojnë 42% (96.296.760,00 din), Preshevës 40,5% (92.857.590,00 din.) dhe Medvegjës 17,5% (40.123.650,00 dinarë). Njëzëri është arritur raporti për punën e Trupit Koordinues, buxheti dhe plani i harxhimeve të mjeteve për këtë vit.

- **Nënshkruhet marrëveshja multietnike për bashkëpunim sportiv në mes të KB „BSK Junior” dhe „Elita”** – Në qendrën sportive „Mlladost” në Bujanoc është nënshkruar Marrëveshja



për bashkëpunimin multietnik në mes të klubeve basketbollistike „BSK Junior” dhe „Elita”. Marrëveshjen e nënshkruan Miroslav Ristiq nga „BSK Junior” dhe Selami Selimi nga KB „Elita”. Kryetari i Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë Milan Marković dhe kryetari i komunës së Bujanocit Shaip Kamberi janë si garantues së kësaj marrëveshje të nënshkruar. Marrëveshja parasheh garat e përbashkëta, kombinimin dhe ndërrimin e lojtarëve të këtyre dy klubeve ku marrin pjesë të rinjë Shqipëtarë, Serbë dhe Romë.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e një bashkëpunimi sportiv afatëgjatë në mes të këtyre dy klubeve në mënyrë që të përmbushen kushtet për angazhimin e një nr sa më të madhë pjesëtarësh që do të merren me këtë sport në Bujanoc.

Klubi basketboillistik multietnik për herë të parë bashkarisht merr pjesë në suaza të ligës verore të basketbollit. Në njërën nga këto ndeshje ka marrë pjesë edhe kryetari i Trupit Koordinues Milan Marković ku me atë rastë u është dorëzuar një fanelë sportive me nr 1. Në këtë ndeshje ministri Marković hodhi topin për fillimin e kësaj ndeshje basketbollistike.

- **Kryetari i Trupit Koordinues Milan Marković raporton qytetarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës**– Kryetari i Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bunajoc dhe Medvegjë, ministri Milan Marković të gjithë qytetarëve u dërgon raportin mbi aktivitetet e Trupit Koordinues. Raporti është i shkruar në gjuhën shqipe, rome dhe serbe dhe u është dërguar në adresat e të gjithë qytetarëve që jetojnë në këto tri komuna. Kjo është hera e dytë që kryetari i Trupit Koordinues u drejtohet me shkrim qdo qytetari të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

- **Mbahet takimi kryetarit të Republikës së Serbisë Boris Tadiq me ministrin Milan Marković dhe deputetin popullorë Riza Halimi** – Kryetari i Republikës së Serbisë Boris Tadiq, ministri i pushtetit, lokal dhe i vetëqeverisjes lokale dhe kryetarë i Trupit Koordinues Milan Marković dhe deputeti popullorë Riza Halimi biseduan mbi punën e Trupit Koordinues dhe përmirësimin e kushteve jetësore në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Gjatë bisedës kanë ardhur në përfundim se formimi i Këshillit Nacional ka rëndësi të madhe për komunitetin shqipëtarë për arsye se në këtë mënyrë ata do të zgjidhin më shpejtë problemet që i preokupojnë, siq janë: arsimit, integrimi, përdorimi zyrtarë i gjuhës shqipe, kultura dhe informimi.

- **Mbahet takimi në Ministrinë e ekonomisë dhe zhvillimit regjional**– Me inisiativën e kryetarit të Trupit Koordinues, ministrit Milan Marković, në shkurt të këtij viti organizohet takimi në Ministrinë ekonomisë dhe të zhvillimit regjional në të cilin përpos ministrit Marković marrin pjesë edhe kryetarët e komunave Ragmi Mustafa, Shaip Kamberi dhe Slobodan Drashković, kryetari i kuvendit komunal të Bujanocit Jonuz Musliu, nënkryetari Trupit Koordinues, sekretari shtetërorë Dejan Jovanović, sekretari shtetërorë Nebojsa Qiriq dhe drejtori i agjensionit për privatizim Vladislav Cvetković. Qështjet ekonomike dhe procesi i privatizimit kanë qenë temat kyçe të këtij takimi. Kryetarët e të tri komunave paraqitën problemet kyçe të ekonomisë dhe zhvillimit ekonomik që i preokupojnë këto tri komuna. Duke marrë parasysh se një ndër prioritetet e Trupit Koordinues është zhvillimi i këtyre tri komunave, është rënë dakord bashkëpunimi më intenziv në sferën ekonomike dhe zhvillimit regjional.

- **Mbahet takimi mbi reformat gjyqësore në Preshevë**– Ndhmësministri pranë ministrisë së drejtësisë Vojkan Simiq takohet me kryetarin e gjyqit të Vranjës, deputetin popullorë Riza Halimi, kryetarët e komunave të Preshevës dhe Bujanocit Ragmi Mustafa dhe Shaip Kamberin. Suksesi më i madh është arritur në sferën e drejtësisë. Problemet në reformën e gjykatave janë specifike për rrethinat multietnike siq është ajo e Preshevës. Këto probleme zgjidhen sipas principeve të multietnicitetit siq pretendon trupi Koordinues, ndërsa zbatohet në përzgjedhjen e gjykatësve dhe personelit administrativ duke mos e rrezikuar profesionalitetit gjyqësorë.

- **Nënkryetari i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe ministri i punëve të jashtme Ilir Meta me kryetarin e Trupit Koordinues Milan Markoviq në vizitë Serbisë jugore** – Kryetari i Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, ministri Milan Markoviq ka qenë nikoqir i nënkryetarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, ministrit të punëve të jashtme Ilir Meta. Ata në Preshevë janë takuar me kryetarin e komunës së Preshevës Ragmi Mustafa dhe kryetarin e kuvendit komunal Skënder Destani. Ministri Ilir Meta gjatë vizitës së tijë deklaroi se në Serbi nuk ka diskriminim.

- **Hapet trafostacioni në zonën industriale „Sektori 6” në Bujanoc** – Në fundë të muajit prill në suaza të zonës industriale „Sektori 6” në Bujanoc hapet trafostacioni i ri. Punën e këtij trafostacioni e shpalli Nenad Gjurgjeviq, drejtor i Shërbimit të Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, ambasadorja Amerikane Meri Vorlik dhe kryetari i komunës së Bujanocit Shaip Kamberi

Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe USAID-i me këtë investim kanë mundësuar punën në këtë zonë industriale. Në elektrifikimin e „sektorit 6” Trupi Koordinues ka investuar 14.779.200,00 dinarë.

- **Mbahet takimi i parë i këshillit drejtues i programit të përbashkët të KB „Ruajtja e paqes dhe zhvillimi inkluziv” (PBILD)** – Në prill është mbajtur Këshilli i parë drejtues i Programit ruajtja e paqes dhe zhvillimi inkluziv. Ky program intersektor nënkupton përparimin e të gjitha segmenteve të jetës në regjionin e Jabllanicës dhe Pçinjës. Qeveria e Serbisë, agjensionet e Kombeve të Bashkuara (UNDP, Unicef, UN, Habitat, Unhcr), Organizata ndërkombëtare e punës (ILO), Organizata ndërkombëtare për migrim dhe donatorët nga Suedia, Norvegjia, Spanja dhe Zvicra në dy vitet e ardhshme do të punojnë në avancimin e komunikimit multietnik, barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, avansimin dhe përmirësimin e kapaciteteve në pushtetet lokale, parandalimin e konflikteve dhe dhunës si dhe zhvillimin ekonomik.

Këshilli drejtues do të përbëhet nga përfqësuesit e Qeverisë së Serbisë, përfaqësuesit e komunave të rrethit të Jabllanicës dhe Pçinjës, Kombeve të Bashkuara, organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve.

- **Mbahet takimi me shfrytëzuesit e mjeteve finansiara të Trupit Koordinues** - Shërbimi i Trupit Koordinues ka organizuar takim me përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve dhe të organizatave joqeveritare të cilat kanë përfituar mjete finansiare në konkurset e Shërbimit të Trupit Koordinues. Takimi është organizuar për analizimin e aktiviteteve në suaza të projekteve të miratuara dhe për të dabatuar për problemet me të cilat ballafaqohen këto organizata apo shoqëri gjatë realizimit të aktiviteteve të projekteve të tyre.

- **Kryetari i Trupit Koordinues për vizitë në Levosovë** – Ministri ka biseduar me anëtarët e



kooperativës bujqësore „Jug Levosoje”. Kjo kooperativë multietnike bujqësore në konkursin e Trupit Koordinues ka përfituar mjete financiare për riparimin e mekanikës bujqësore dhe blerjen e farës për mbjelljet pranverore. Ministri Markoviq bujqëve u propozoi bashkëpunim me qumështoren e Shabacit si dhe i inkurajoi që edhe më tej të kërkojnë ndihmë financiare nga Trupi Koordinues i cili gjithnjë është i gatshëm të financojë projekte të tilla multietnike. Si rezultat i kësaj vizite dhe nën iniciativëne Trupit Koordinues, është organizuar takimi në mes

të ministrit të bujqësisë Sasha Dragin me përfaqësuesit e kooperativës bujqësore „Jug Levosoje” dhe përfaqësuesëve të qumështores Shabac. Me këtë rast është biseduar që në muajin qershorë përfaqësuesit e qumështores Shabac të vizitojnë Levosovën dhe fshatrat përreth në mënyrë që të informohen rreth kapaciteteve në prodhimtarinë e qumështit në këto fshatra. Trupi Koordinues dhe Ministria e bujqësisë mundohen të gjejnë një zgjidhje se në qfar mënyre mundë të ndihmojnë që blektoria dhe bujqësia të lulëzojnë në këto treva të Serbisë jugore.

Kryetari i Trupit Koordinues ka vizituar shkollën fillore „Vuk Karaxhiq”. Ministria e pushtetit lokal dhe vetëqeverisjes lokale finanson përpilimin e dokumentacionit për ndërtimin e një salle të edukatës fizike në këtë shkollë. Ministri u premtoi asfaltimin e terenit përreth shkollës dhe në riparimin e kuzhinës shkollore.

Përpos aktivitetëve të lartëpërmendura të Trupit Koordinues, do të potencojmë edhe:

- **Qeveria miraton buxhet më të lartë për Trupin Koordinues** – Qeveria e Republikës së Serbisë në buxhetin për vitin 2010 ka paraparë rritje të mjeteve financiare për punën e Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Sipas buxhetit i cili është miratuar më 21 dhjetorë, Trupi Koordinues do të ketë në dispozicion 421.550.000 dinarë. Në krahasim me vitin e kaluar, buxheti i Trupit Koordinues për vitin 2010 është rritur për 10%.

- **Kremtimi i përvjetorit të fakultetit Juridik në Nish-** Kryetari i Trupit Koordinues, ministri Milan Markoviq ka marrë pjesë në festimin e 50 vjetorit të egzistimit dhe punës së fakultetit Juridik të Nishit.

- **Dita e komunës së Medvegjës** – Me rastin e ditës së Medvegjës, kryetarit të Trupit Koordinues, ministrit Milan Markoviq u dorëzohet plaketa e artë për angazhimet dhe meritat në zhvillimin ekonomik të Medvegjës.

- **Konferenca „Serbia Jugore – nga konflikti i ngrirë deri te mundësitë e integritit afatëgjatë dhe zhvillimit të regjionit”** – Në përvjetorin e rekonstruimit të Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, BIRN (Balkan Investigative Reporting Network) ka organizuar konferencën ndërkombëtare në të cilën është hapur debati mbi zhvillimin e regjionit dhe mundësisë së integritit të mëtutjeshëm të Shqipëtarëve në institucionet shtetërore. Trupin Koordinues në këtë konferencë e ka prezentuar kryetari Milan Markoviq dhe drejtori Nenad Gjurgjeviq.

Qëllimi i Trupit koordinues është që përmes partneritetit me ministritë e tjera qeveritare të Republikës së Serbisë, me organizatat ndërkombëtare dhe me përfaqësuesit e ashkësisë ndërkombëtare t'i kontribuojë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Trupi koordinues përpiqet t'i përparojë kapacitetet e pushteteve lokale dhe të shoqërisë civile, ashtu që vetë të mund të kujdesen për zhvillimin vetanak, pa u mbështetur në ndihmat emergjente me të cilat nuk ka përmirësim të situatës në shtigje afatgjate, që nuk është e qëndrueshme dhe nuk i kontribuon uljes së varfërisë të këtyre komunave.

Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë
për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

Tel: 011 21 20 906

011 21 20 907

Faks: 011 21 20 909

E-mail: office@kt.gov.rs